

A është evolucioni në pajtim me Kristianizmin?

Ndërsa mësoja më shumë për teorinë e evolucionit, u bë gjithnjë e më e dukshme se, në vend që të ishte një pamje e origjinës e cila ka nxitje shkencore, shumë shpesh, ajo ka *nxitje ideologjike*. Për më tepër dhe me një shqetësim më të madh, nuk është e vështirë të shihet se kjo ideologji është thelbësisht anti-Kristiane në natyrë. Sipas Adam Sexhuik [Adam Sedgwick], që ishte Profesor Woodwardian i Gjeologjisë në Universitetin e Keimbrixhit dhe e njihnte mirë Darwinin, kështu ka qenë që nga fillimi. Një vit pas botimit të *Origjina e Llojeve*, Sexhuik shkroi për këtë, “Që nga shkronja e parë deri tek e fundit, ajo është një gjellë e një materializmi luksoz e gatuar me zgjuarsi dhe e shërbyer ... Dhe përse është bërë kjo? Për asnjë arsye tjetër të fortë, unë jam i sigurt, përveçse që të na bëjë ne të pavarur nga një Krijues.”¹

Sipas Dr. Croft, familja e Darwinit, shumë shpejt pas vdekjes së tij, me qëllim i shkatërroi shumë prej shkrimeve të tij që t’i fshihte ndjenjat e tij anti-Kristiane.² Duke folur njëqind vjet pas botimit të *Origjinës së Llojeve*, biologu Sër Xhulian Hakslei [Julian Huxley] FRS debatoi, ‘Darvinizmi e hoqi të tërë idenë e Perëndisë si krijuesi i organizmave nga sfera e diskutimeve të arsyeshme.’³

Profesori Doukins e pranon hapur se ai shkruan libra për evolucionin, me qëllim që të promovojë ateizmin. Kur u pyet për reagimin tij ndaj faktit se shumica e njerëzve në Britani besojnë në Perëndinë, ai u përgjigj, ‘Unë nuk jam i lumtur që jetoj në një shoqëri ku mendoj se shumica e njerëzve janë mashtruar. Unë do të doja të bëja diçka për të, dhe ja përse shkruaj librat që shkruaj.’⁴ Sipas Profesorit Stark,

... beteja me evolucionin nuk është një shembull i se si shkencëtarët ‘heroikë’ i kanë qëndruar përndjekjes së pamëshirshme nga ana e ‘fanatikëve’ fetarë. Përkundrazi, që nga fillimi ajo ka qenë një sulm mbi fenë nga ana e ateistëve militantë që e mbështjellin veten me mantelin e shkencës në një përpjekje për t’i hedhur poshtë të gjitha pretendimet fetare li-

dhur me një Krijues—një përpjekje që gjithashtu shpesh është përpjekur t'i shtypë të gjitha kritikant ndaj punës së Darvinit.⁵

Me të vërtetë, beteja për ta mbrojtur Darwinin është bërë me kaq zjarr, sa që edhe evolucionistët janë kritikuar shumë nëse gjejnë gabime në të. Kur evolucionisti Riçard Milton botoi librin e tij *Shkatërrimi i Miteve të Darwinizmit*, duke sugjeruar se nevojitet një teori alternative për teorinë e evolucionit, Profesori Dawkins u përgjigj duke i sulmuar botuesit 'për papërgjegjshmërinë e tyre në të guxuarit për ta pranuar një libër që kritikon Darwinizmin'.⁶ Në mënyrë të ngjashme, kur në vitin 1981 Muzeu Britanik i Historisë njerëzore hapi një ekspozitë mbi teorinë e Darvinit, dështimi i tyre për ta prezantuar atë si fakt shkaktoi dhunë. Stafi i muzeumit nuk ishin kreacionistë, por besonin se teoria e Darvinit duhej të vihej në pikëpyetje. Ata sugjeruan, për shembull, se 'koncepti i evolucionit prej përzgjedhjes natyrore nuk është, duke folur në mënyrë strikte, shkencor' dhe se 'ai një ditë mund të zëvendësohet nga një teori më e mirë'.⁷ Në shtator të vitit 2008, evolucionistit, Profesor Majkëll Reis [Michael Reiss] iu desh të hiqte dorë nga pozita e tij si Drejtor për Arsimin në Shoqërinë Mbretërore, për shkak se ai kishte shprehur pikëpamjen se fëmijët duhet të lejojnë të ngrejne dyshime për teorinë e evolucionit në lëndët ku marrin mësim për shkencën dhe të diskutojnë pikëpamjet alternative për origjinën.⁸ Sipas pikëpamjes sonë, entuziazmi me të cilin disa evolucionistë tentojnë t'u mbyllin gojën të gjithëve që do ta kritikonin ose edhe do ta vinin në pikëpyetje teorinë e Darvinit sugjeron se ose ata kanë diçka për të fshehur, ose kanë një axhendë tjetër jo-shkencore (ose të dyja). Shkencëtarët e vërtetë e dinë se vlerësimi kritik i teorive të tyre është thelbësor për progresin shkencor.

Në mënyrë të konsiderueshme, edhe shkencëtarët që nuk kanë ndonjë përkushtim ndaj parimeve të tilla si projektimi me inteligjencë shprehin shqetësim për natyrën ideologjike të teorisë së evolucionit. Fituesi i çmimit Nobel, Profesori Robert Laughlin, për shembull, argumenton,

Një simptomë kryesore e të menduarit ideologjik është shpjegimi që nuk ka asnjë ngatërrim dhe që nuk mund të testohet. Unë i quaj këta funde të vdekur logjikë anti-teori, për shkak se ata kanë saktësisht efektin e kundërt të teorisë së vërteta: ata e ndalojnë të menduarin, në vend që ta stimulojnë atë. Evolucioni prej përzgjedhjes natyrore, për shembull, të cilin Darvini e konsideronte si një teori të madhe, kohët e fundit ka nisur të funksionojë si një anti-teori, së cilës i drejtohen për t'i mbuluar mangësitë eksperimentale të turpshme dhe për

Kapitulli 11

të legjitimuar gjetjet që në më të mirën e tyre janë të diskutueshme... Proteina juaj i përcakton ligjet e veprimit të masës? Evolucioni e bëri atë! Përzjerja e ngatërruar e reaksioneve kimike shndërrohet në pulë? Evolucioni! Truri njerëzor funksionon bazuar mbi parimet logjike që asnjë kompjuter nuk mund ta rivalizojë? Evolucioni është shkaku!⁹

Sipas profesorit Edvin G. Conklin, ish Profesor i Biologjisë në Universitetin Princeton, Darwinizmi shumë shpejt u bë një fe. Duke shkruar në gjysmën e parë të shekullit të njëzetë, ai argumentoi, ‘Koncepti i evolucionit organik është çmuar shumë lart prej biologëve, për shumë prej të cilëve është një objekt i përkushtimit të sinqertë fetar ... Kjo është ndoshta arsyeja se përse kritikizmi i ashpër metodologjik i përdorur në departamentet e tjera të biologjisë ende nuk ka ardhur në gjendje të mbartë spekulimet evolucioniste.’¹⁰ Në mënyrë të ngjashme filozofi dhe historiani kryesor në shkencë, Profesori Marjorie Grene mbronte se, ‘Ajo që Darwinizmi bëri kryesisht ishte se ai i mbërthente dhe ende i mbërthen mendjet e njerëzve, si një *fe e shkencës* ... Teoria e modifikuar, por ende karakteristike Darwiniane vetë është bërë një ortodoksi, e predikuar nga përkrahësit e saj me një zell fetar, dhe e vënë në dyshim, ndihen ata, vetëm prej pak ngatërrestarëve, të papërsosur në besimin shkencor.’¹¹

Kohët e fundit, Majkëll Rus [Michael Ruse], që ishte Profesor i Filozofisë dhe Zoologjisë në Universitetin e Guelph, Kanada, komentoi,

Evolucioni promovohet nga praktikuesit e tij si më tepër se sa thjesht shkencë. Evolucioni është shpallur si një ideologji, një fe ateiste—një alternativë me të drejta të plota ndaj Kristianizmit, me kuptim dhe moralitet. Unë jam një evolucionist i zellshëm dhe një ish-Kristian, por ... literalistët kanë absolutisht të drejtë. Evolucioni është një fe. Kjo ishte e vërtetë për evolucionin në fillimet e tij, dhe është e vërtetë për evolucionin ende sot... Evolucioni, për këtë arsye erdhi në ekzistencë si një lloj i ideologjisë laike, si një zëvendësues i qartë i Kristianizmit.’¹²

Për të tjerët, teoria e evolucionit shprehet si një mohim absolut i Kristianizmit dhe normave të tij themelore. Profesori Xhorxh Geilord Simpson [George Gaylord Simpson] deklaroi, ‘Njeriu është rezultat i proceseve të paqëllimta dhe natyrore që nuk e kishin aspak ndër mend atë.’¹³ Në mënyrë të ngjashme, oxhak-fshirësja e ‘shkencës’ së Profesorit Provaijn [Provine] të le pa frymë. Sipas tij, teoria e evolucionit tregon se njerëzimi nuk ka asnjë qëllim, ajo themelon ateiz-

min, heq gjërat absolute morale, hedh poshtë ringjalljen dhe mohon konceptin e përgjegjshmërisë morale:

Shkenca moderne implikon direkt se bota është e organizuar në mënyrë strikte në pajtim me parimet e mekanikës. Nuk ka asnjë lloj parimi të qëllimshëm në natyrë ... Nuk ka perëndi dhe as forca projektuese që janë të dallueshme në mënyrë të arsyeshme ... shkenca moderne implikon direkt se nuk ka ligje të qenësishme morale apo etike, nuk ka parime udhëzuese absolute për shoqërinë njerëzore ... kur vdesim, ne vdesim dhe ky është fundi ynë ... vullneti i lirë ... thjesht nuk ekziston ... Nuk ka asnjë mënyrë në të cilën procesi evolucionist ... të mund të prodhojë një qenie që është vërtet e lirë për të bërë zgjedhje.¹⁴

Evolucioni, debatoj unë, është një filozofi materialiste që nxitet nga ana ideologjike, efekti primar i së cilës ka qenë të heqë nga njerëzimi njohurinë për Perëndinë. Sot shkencëtarët kryesorë debatojnë jo vetëm që Bibla është një libër mitesh dhe idesh të rreme (gjë që është provuar se është gabim, për shembull, nga teoria e evolucionit), por edhe që të menduarit Kristian është dëmtues. Ndoshta kjo nuk është askund më e dukshme se sa në dokumentarin televiziv të Profesorit Dawkins [Dawkins], *Rrënja e të Gjitha të Këqijave?*,¹⁵ dhe libri i tij *Perëndia Mashtrim*.¹⁶ Në SHBA, grupe laike presioni kanë bërë fushata të suksesshme për ta hequr Kristianizmin nga shkollat (mbi bazën se ai shkel kërkesën kushtetuese për ta ndarë kishën nga shteti) dhe për të siguruar që evolucionit të mësohet si një fakt. Efektiviteti i tyre është ilustruar nga një rast i fundit kur avokatët e punësuar nga Unioni Amerikan i Lirive Civile (UALC) ishin të dobishëm në fitoren e një gjyqi kundër Bordit të Arsimit në Kontenë Kob. Për pasojë, Bordi u detyrua që t'i hiqte etiketat nga tekstet e shkollës për lëndët shkencore, të cilat përmbanin thënien e mëposhtme: 'Ky libër shkollë përmban material mbi evolucionin. Evolucionit është një teori, jo një fakt, lidhur me origjinën e gjallesave. Ky material duhet parë me një mendje të hapur, duhet studiuar me kujdes dhe të konsiderohet në mënyrë kritike.'¹⁷

Ajo që është kaq e spikatur për këtë rregull është se është e qartë se fjalët e përdorura nuk përmbanin absolutisht asnjë referencë për besimin fetar. Për grupet si UALC, prezantimi i teorisë së evolucionit si një 'fakt i provuar' është një armë e fuqishme në betejën për mendjet e njerëzve dhe për të themeluar një pikëpamje botërore laike. Ajo i bind shumë veta se të menduarit Kristian është i dalë mode dhe se ne duhet të përqafojmë një shoqëri më liberale, pa 'kufizimet' e moralitetit Kristian.¹⁸ Veprime të ngjashme mund të priten në Evropë. Në qer-

Kapitulli 11

shor 2007, një komitet i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës botoi një raport me një draft rezolutë të titulluar *Rreziqet e Kreacionizmit në Arsim*. Kjo argumentonte se kreacionizmi është një kërcënim serioz për përparimin mjekësor, ‘të drejtat e njerëzve’ dhe demokracinë.¹⁹ Pak muaj më vonë, rezoluta u miratua, me pak ndryshime të vogla, me dyzet e tetë vota pro ndaj njëzet e pesë kundër, duke përsëritur se ‘kreacionizmi mund të bëhej një kërcënim për të drejtat e njeriut’.²⁰ Në tetor 2007, qeveria Suedeze vendosi ‘të marrë masa të rrepta ndaj rolit që luan feja në shkollat shtetërore të pavarura’²¹ duke ndaluar mësuesit e biologjisë të mësojnë kreacionizmin ose projektimin inteligjent bashkë me evolucionin. Sipas Ministrit të Arsimit, Jan Björklund, kjo u bë që fëmijët të ‘mbroheshin nga të gjitha format e fundamentalizmit’.²²

Sipas apostullit Pal, ‘cilësitë e padukshme të Perëndisë—fuqia e tij e përjetshme dhe hyjnia e tij—duke qenë të dukshme nëpërmjet veprave të tij që nga krijimi i botës, shihen qartë, me qëllim që ata të jenë të pafalshëm.’ (Romakëve 1:20). Magnituda e kozmosit, me miliardat e galaktikave të tij i sjellë në ekzistencë thjesht me anë të fjalës së Perëndisë, flet me gojëtarin për një Krijues të plotfuqishëm (Zanafilla 1:14-15). Ndërlikueshmëria e mbretërive të bimëve dhe të kafshëve janë një dëshmi e pamohueshme e një Krijuesi të gjithëdijshëm. Bukuria e natyrës, muzika dhe artet tregojnë për një Krijues të mirë. Në të njëjtën kohë, vuajtja e përhapur dhe vdekjet kudo në botë shpallin se diçka ka shkuar keq, dhe se ne jemi të detyruar të pyesim, ‘Përse e ka lejuar këtë Krijuesi ynë?’ Atëherë ne mund të kthehemi te Bibla për përgjigjet. Bibla na mëson se Perëndia bëri një botë të përsosur dhe një burrë e një grua të përsosur (Zanafilla 1:31). Ata nuk kishte përse të punonin shumë që të mbijetonin pasi toka e prodhonte me lehtësi ushqimin që u duhej (rritja e bimëve për ushqim u bë e mundimshme vetëm pasi ata mëkatuan, siç është e qartë nga Zanafilla 3:17 – 19 dhe 5:29); dhe nuk do të kishte asnjë njeri apo kafshë mishngrënëse (Zanafilla 1:29-30). Nuk do të kishte pasur asnjë sëmundje dhe asnjë dhimbje fizike apo emocionale, sepse Perëndia krijoi një parajsë në të cilën njeriu do të jetonte me gëzim të madh dhe në harmoni. Ajo që është më e rëndësishme, ne nuk do të plakeshim e nuk do të vdisnim. Por për shkak të mëkatit, për shkak se njerëzimi u largua prej Perëndisë dhe u kthye ndaj së keqes, mbi ne erdhi gjykimi i Perëndisë. Ne tani jetojmë në një klimë të ashpër; ne kemi luftëra, urrejtje, uri, divorc dhe hidhërim të madh, dhe që të gjithë një ditë do të vdesim. Por gjithashtu ka një lajm të mirë për ata që do të duan ta pranojnë atë. Perëndia dërgoi Birin e tij të vetëm, Jezus Krishtin, në botë për të paguar çmimin për mëkatin duke vdekur

në kryq. Pas tri ditësh, Perëndia e ngjalli atë prej të vdekurve në mënyrë që të gjithë ata që e pranojnë Krishtin të mund të marrin faljen e mëkateve dhe një jetë të re, të perëndishme përmes tij. Perëndia premtonte gjithashtu që do t'i ngrerë nga të vdekurit të gjithë ata që janë në Krishtin—dhe për një jetë më të mirë nga ajo që iu dha Adamit dhe Evës.

Por teoria e evolucionit e mohon të gjithë këtë. Sipas kësaj teorie, cilësitë hyjnore të Perëndisë nuk shihen në natyrë, pasi jeta në tokë është produkt i shansit dhe i proceseve natyrore. Në vend të interpretimit se vuajtjet dhe vdekja janë rezultat i mëkatit, ata sipas kësaj teorie ishin mjetet me anë të të cilave jeta u zhvillua, përmes 'mbijetesës së më të fortit'. Në vend të Perëndisë që krijoi diçka që ishte në çdo kuptim shumë e mirë, ashtu siç pohon Bibla, që nga fillimi ekzistoi një mjedis pa harmoni, me konflikt dhe me konkurrencë të skajshme. Sipas këtij mendimi, imoraliteti seksual, agresioni i paperëndishëm, krenaria dhe brutaliteti nuk janë rezultat i mëkatit por i forcave evolucionare dhe janë të natyrshme. Përpara se njerëzve t'u mësohej se 'evolucioni është një fakt dhe se Bibla është plot me mite', ata panë në natyrë dëshminë e pamohueshme të një Perëndie krijues. Ata e respektonin Biblën dhe u mësuan për mëkatin dhe mënyrën e shpëtimit dhe kjo kishte kuptim. Ata u sollën ballë për ballë me Krishtin historik dhe real dhe shumë e pranuan atë si Shpëtimtar dhe Zot. Për më tepër, parimet dhe doktrinat e rëndësishme Kristiane i kanë themelet e tyre në interpretimet e drejtpërdrejta nga Zanafilla; këto përfshijnë doktrinën e mëkatit fillestar (Zanafilla 3; Romakëve 5:12-19), martesën Kristiane (Zanafilla 2:20-24) dhe realitetin e gjykimit të Perëndisë (Zanafilla 2:17; kapitulli 6). Nëse pranohet se Bibla nuk mund të besohet në çështjet e historisë, njerëzit në mënyrë të pashmangshme do ta venë në dyshim nëse ajo mund të besohet në çështjet e doktrinës dhe moralitetit. Me të vërtetë, teoria e evolucionit është shfaqur hapur kundër të vërtetës Kristiane: ajo ia vjedh lavdinë Perëndisë, e ngatërron ungjillin dhe e minon autoritetin didaktik dhe moral të Biblës.

Një lexim i natyrshëm i Dhjatës së Re do të sugjeronte se Krishti e pranoi një interpretim fjalë për fjalë të Dhjatës së Vjetër, duke besuar për shembull në historinë e Adamit dhe Evës dhe në Përmbytjen e Noeut (Mateu 19:4-5; Lluka 17:26-27). Me të vërtetë, ai vlerësoi se 'Shkrimi nuk mund të bjerë poshtë' (Gjoni 10:35) dhe se 'është më lehtë që të mbarojnë qielli dhe toka, se sa të bjerë poshtë qoftë edhe një pikë nga ligji' (Lluka 16:17). Përse i tha ai këto gjëra? Sigurisht kjo ndodhi pasi çështja e autoritetit biblik është me rëndësi jetike.

Bibla është libri më i çmuar. Ajo na mëson të vërtetat thelbësore për Perëndinë

Kapitulli 11

dhe veten tonë dhe u përgjigjet pyetjeve më të rëndësishme për jetën. Ai na tregon se nga erdhëm dhe çfarë do të thotë të jesh njeri. Në të, ne gjejmë manualin udhëzues të Krijuesit tonë, që na informon se si të jetojmë. Ai na mëson se çfarë është e drejtë e çfarë gabim dhe na këshillon se si të shmangim shumë kurthe të jetës. Duke e kuptuar atë, ne mësojmë të mendojmë drejt, ashtu si mendon Perëndia, dhe arrijmë të njohim vetveten. Për më tepër, ne mund të arrijmë ta njohim Perëndinë, natyrën e tij, shenjtërinë e tij pa kompromise dhe dashurinë që ka ai për ne. Duke e gjetur Atë, ne mund t'i shmangemi zbrazëtisë së filozofive natyrore dhe mund të zbulojmë kuptimin dhe qëllimin e vërtetë. Por shtegu drejt kësaj njohurie është i ngushtë (Mateu 7:14) dhe e vërteta nuk rroket aq lehtë. Ajo duhet kërkuar me zell (Fjalët e Urta 2:1-5) dhe gjendet vetëm prej atyre që i ndjekin plotësisht parimet e tij (Gjoni 8:31-32). Nuk mund të ketë asnjë lëkundje, sepse përkushtimi ndaj Krishtit duhet të jetë i plotë. Ata që e dyshojnë Fjalën e Perëndisë do të jenë të pasigurt për shtegun e tyre dhe do t'ia kenë grabitur lavdinë asaj. Vetëm duke e përqaftuar me zemër të pastër Biblën ne mund 'ta duam Perëndinë, Zotin [tonë] me gjithë zemrën tonë, me gjithë shpirtin [tonë] dhe me gjithë mendjen [tonë]' (Mateu 22:37). Por nëse mësojmë ta duam fort atë, Bibla do të bëhet për ne një burim i një ripërtëritjeje të përjetshme. Atëherë ne mund të ushqehemi me Bukën e Jetës (Gjoni 6:35), të pijmë nga Burimi i Përjetshëm (Gjoni 7:37-39) dhe të vazhdojmë të ngulmojmë për të zbuluar 'pasuritë e papërshkrueshme të Krishtit' (Efesianëve 3:8).

Shënimet

- 1 **John W. Clark** dhe **Thomas Hughes**, *The Life and Letters of the Rev. Adam Sedgwick*, vol. 2 (Cambridge University Press, 1890), fq. 359–360.
- 2 **Lawrence R. Croft**, *The Life and Death of Charles Darwin* (Chorley: Elmwood Books, 1989), fq. 95. Shih edhe **Russell Grigg**, *Darwin's Arguments Against God*, 13 June 2008, te: creationontheweb.com.
- 3 Cituar te **Sol Tax** dhe **Charles Callender**, (eds.), *Evolution After Darwin*, vol. 3 (Chicago: University of Chicago Press, 1960), fq. 45.
- 4 Cituar te **John Blanchard**, *Evolution: Fact or Fiction?* (Peabody, MA: Evangelical Press, 2002), fq. 28.
- 5 **Rodney Stark**, *For the Glory of God: How Monotheism Led to Reformations, Science, Witch-hunts and the End of Slavery* (Princeton: Princeton University Press, 2003), fq. 176.
- 6 **Richard Milton**, *Shattering the Myths of Darwinism* (1st edn.; Rochester, VT: Fourth Estate, 1997), Preface.
- 7 **Phillip Johnson**, *Darwin on Trial* (2nd edn.; Downers Grove, IL: InterVarsity Press, 1993), fq. 133–142.
- 8 **Michael Reiss**, 'Should Creationism be a Part of the Science Curriculum?', BA Festival of Science, 11 September 2008; **Lewis Smith** and **Mark Henderson**, 'Royal Society's Michael Reiss Resigns over Creationism Row', 17 September 2008, te: timesonline.co.uk.

A është evolucioni në pajtim me Kristianizmin?

- 9 **Robert Laughlin**, *A Different Universe: Reinventing Physics from the Bottom Down* (New York: Basic Books, 2005), fq. 168–169.
- 10 Cituar prej **William R. Fix**, *The Bone Peddlers* (New York: Macmillan, 1984), fq. 211.
- 11 **Marjorie Grene**, 'The Faith of Darwinism', *Encounter*, 13/5 (1959), fq. 48–56.
- 12 **Michael Ruse**, 'How Evolution Became a Religion: Creationists Correct?', *National Post*, 13 May 2000, fq. B1, B3, B7.
- 13 Cituar te **Johnson**, *Darwin on Trial*, fq. 116.
- 14 Cituar po aty. fq. 127.
- 15 *Root of all Evil?*, Channel 4, January 2006, Episodet 1 dhe 2.
- 16 **Richard Dawkins**, *The God Delusion* (London: Transworld, 2006).
- 17 Northern District of Georgia, Atlanta Division, Civil Action 1 02-CV-2325-CC, January 2005.
- 18 Sipas Koalicionit të Vlerave Tradicionale Amerikave (ACLU) është aktive jo vetëm për promovimin e mësimit të evolucionit në shkolla, por gjithashtu për ta zhveshur Amerikën nga trashëgimia e saj Judeo-Kristiane, për të kundërshtuar censurimin, për të mbrojtur pornografët dhe ata që bëjnë aborte, dhe nën flamurin e mbrojtjes së lirisë së fjalës, për të mbështetur hapur grupet e pedofilëve të tillë si Shoqata e dashurisë Burrë-Djalosh e Amerikës së Veriut. Shih: traditionalvalues.org/pdf_files/ACLU.pdf.
- 19 *The Dangers of Creationism in Education*, Council of Europe Committee on Culture, Science and Education, Doc. 11297, 8 June 2007.
- 20 'Council of Europe to Vote on Creationism', ABC News, 26 September 2007, te: abc.net.au; 'Council of Europe States Must "Firmly Oppose" the Teaching of Creationism as a Scientific Discipline, Say Parliamentarians', Deklaratë shtypi e Këshillit të Evropës, 4 October 2007, te: assembly.coe.int.
- 21 Shumica e shkollave të pavarura Suedeze janë në pronësi private por financohen nga grantet e qeverisë.
- 22 'Creationism to be Banished from Swedish Schools', *The Local*, 15 October 2007.